



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.47, datë 18.10.2023

PËR
RISHIKIMIN E KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT DHE NDRYSHIM
DESTINACIONI, PËR OBJEKTIN: “HOTEL 6 KATE, RESTORANT E SHËRBIME
TREGTARE 1 KAT SI DHE REZIDENCA SEZONALE 5 KATE MBITOKË ME 1 KAT
PARKIM NËNTOKË”, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Dyrrakium” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit dhe ndryshim destinacioni për objektin: “Hotel 6 kate, restorant e shërbime tregtare 1 kat si dhe rezidenca sezonale 5 kate mbitokë me 1 kat parkim nëntokë”, Bashkia Durrës, e miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.18, datë 17.05.2019, me subjekt zhvillues shoqërinë “Dyrrakium” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.18, datë 17.05.2019, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.





MINISTËR LINJES

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 03 / 10 /2024